



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), të nenit 3 të Rregullorës së UNMIK-ut mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe Rregullave të Procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 29.03.2007, merr

V E N D I M

MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01.NR.353-263 DT. 04.03.2003 MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË KATEDRALËS KATOLIKE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01.Nr.353-263, të dt. 06.03.2003, mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike në Prishtinë.

Neni 2

Neni 2 i Vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike në Prishtinë nr. 01-353-263 të datës 04.03.2003 ndryshohet dhe bëhet:

“Për ndërtimin e objektit të Katedralës Katolike caktohet ngastra kadastrale nr. 7355 Komuna Kadastrale Prishtinë në sipërfaqe prej 68.11 ari, pronë e Komunës”.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR. 353-135 DT. 29.03.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri